



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri:** KSC-BC-2020-06  
**Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

**Për:** Gjykatësin e Procedurës Paraprake  
Gjykatësi Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Parashtrori:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 16 nëntor 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Njoftim për miratimin e bashkëmbrojtësit të Jakup Krasniqit**

**me një shtojcë konfidenciale**

---

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtëses së Jakup Krasniqit**

Venkatesvari Alagenda

1. Në pajtim me rregullën 26(1) të Rregullores<sup>1</sup>, nëpërmjet këtij njoftimi Administratorja informon Gjykatësin e Procedurës Paraprake për miratimin e bashkëmbrojtësit për zotin Jakup Krasniqi (“z. Krasniqi”).
2. Më datë 6 nëntor 2020, Administratorja e informoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake për emërimin e zonjës Venkatesvari Alagenda si mbrojtëse të z. Krasniqi.<sup>2</sup>
3. Më datë 13 nëntor 2020, zonja Venkatesvari Alagenda i paraqiti shefit të Zyrës së Mbrojtjes një kërkesë për miratimin e zotit Ejden Elis (Aidan Ellis) si bashkëmbrojtës, shoqëruar me dokumentacionin përkatës në pajtim me pjesën 18 të Direktivës për Mbrojtësit.<sup>3</sup>
4. Z. Elis është pranuar në Listën e Mbrojtësve në pajtim me pjesën 7(2) të Direktivës për Mbrojtësit.<sup>4</sup>
5. Më datë 13 nëntor 2020, Administratorja e miratoi z. Elis si bashkëmbrojtës për z. Krasniqi në pajtim me pjesën 18 të Direktivës për Mbrojtësit.<sup>5</sup>
6. Ky parashtrim parashtrohet me klasifikimin publik, ndërsa shtojca 1 parashtrohet me klasifikimin konfidencial në pajtim me rregullën 82(1)(b) dhe (3) të Rregullores, duke qenë se përmban të dhëna personale për mbrojtësin dhe bashkëmbrojtësin.

**Numri i fjalëve (në origjinal): 243**

/nënshkrimi/

**Dr. Fidelma Donlon**  
**Administratore**

---

<sup>1</sup> Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara, KSC-BD-03/Rev3/2020, (“Rregullorja”); *shih edhe* Ligji Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015, nenet 21(4), 21(5), 34(7) dhe 41(4)(b).

<sup>2</sup> Njoftim për emërimin e mbrojtësit për Jakup Krasniqin, KSC-BC-2020-06/F00058, 6 nëntor 2020, publik.

<sup>3</sup> Direktivë për Mbrojtësit, KSC-BD-04, 6 nëntor 2017.

<sup>4</sup> Vendimi për pranimin në Listën e Mbrojtësve të Specializuar, KSC/REG/DEF/0037, 2 maj 2018.

<sup>5</sup> Shtojca 1, Letërmiratimi për përzgjedhjen e bashkëmbrojtësit, KSC/REG/IOR/3367, 13 nëntor 2020.

E hënë, më 16 nëntor 2020  
Hagë, Holandë